



I Dërguari i Allahut ﷺ ka qenë njeriu më bujar, e bujaria e tij arrinte kulmin gjatë Ramazanit, kur e takonte Xhibrili

Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "I Dërguari i Allahut ﷺ ka qenë njeriu më bujar, e bujaria e tij arrinte kulmin gjatë Ramazanit, kur e takonte Xhibrili. E takonte atë çdo natë Ramazani dhe e mësonte Kuranin me të. I Dërguari ﷺ në vepra të mira ka qenë më bujar sesa era që fryn (plot mirësi)."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ ishte njeriu më bujar, e bujaria e tij ishte kulmore gjatë muajit Ramazan, meqë e jepte atë që kërkohet për ata që kishin nevojë. Fakti se bujaria e tij ishte kulmore janë dy shkaqe: I pari: Takimi që e kishte me Xhibrilin (alejhi selam). I dyti: Mësimi i Kuranit së bashku, respektivisht leximi i tij përmendsh. Xhibrili (alejhi selam) i mësonte Profetit ﷺ çdo gjë që i qe shpallur nga Kurani, kështu që i Dërguari i Allahut ﷺ ishte më bujar, më bamirës dhe veprues i hairit, dhe më i shpejtë për t'u sjellë dobi njerëzve sesa era e mirë që e dërgon Allahu me shi e mëshirë.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/6179>

